

20251543375

LIGJ PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT TË SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR

Neni 1

Në Ligjin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë " nr. 98/12, 166/12, 15/13, 170/13, 43/14, 44/14, 97/14, 113/14, 160/14, 160/14, 160/14 15, 129/15, 147/15, 154/15, 173/15, 217/15, 27/16, 120/16, 132/16, 35/18, 220/18 dhe 245/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 180/19, 275/19, 31/20, 267/20, 67/22, 79/23 dhe 193/24 dhe 75/25), në nenin 127, paragrafi (1), fjalët: "vendi i sigurimit të fundit" zëvendësohen me fjalët: "vendbanimi i të siguruarit".

Neni 2

(1) Dispozitat e nenit 37 në Ligjin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 98/12, 166/12, 15/13, 170/13, 43/14, 44/14, 97/14, 113/14, 160/14, 160/14, 160/14 15, 129/15, 147/15, 154/15, 173/15, 217/15, 27/16, 120/16, 132/16, 35/18, 220/18 dhe 245/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 180/19, 275/19, 31/20, 267/20, 67/22, 79/23 dhe 193/24 dhe 75/25), paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji nuk zbatohen në periudhën nga 1 shtator 2025 deri më 31 mars 2026.

(2) Të gjitha llojet e pensioneve, të paguara në Republikën e Maqedonisë së Veriut, më 1 shtator 2025 dhe 1 mars 2026 harmonizohen në mënyrë të tillë që shuma totale mujore e fituar nga përqindja për rritjen e pensioneve e përlogaritur nga shuma prej 50% të rritjes së indeksit të kostos së jetesës dhe 50% të rritjes së pagës mesatare të paguar të të gjithë të punësuarve në Republikën e Maqedonisë së Veriut në gjysmëvjetorin e mëparshëm në raport me gjysmëvjetorin që i paraprinë, të publikuar nga Enti Shtetëror i Statistikës, pjesëtohet me numrin e përgjithshëm të përfituesve të pensioneve që e kanë përfituar të drejtën e pensionit përfundimisht me 31 gusht 2025, përkatësisht 28 shkurti 2026.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.